



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:159720  
Datë: 11.03.2024  
Numri i dokumentit: 05431648

**Ac.nr.153/2022**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka - kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Frosina Sylejmani- anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A. Z. B. nga Mitrovica rruga xxxxx e përfaqësuar nga Sh. M. J. , avokate nga M., rruga xxxx pn kundër të paditurës Komuna e Zubin Potokut –Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën e përfaqëson Nebojsa Vlajic , avokat nga Mitrovica rruga xxxxx , me objekt kontesti kompensim në emër të licencimit , vlera e kontestit 2.273,40 euro, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Zubin Potok, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.33/2021, të datës 28.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më **06.03.2024** nxjerr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET si e pa themeltë** ankesa e të paditurës, Komuna e Zubin Potokut –Drejtoria Komunale për Arsim, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Zubin Potok, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.33/2021, i datës 28.10.2021, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.33/2021 të datës 28.10.2021 ka vendosur si në vijim:

**APROVOHET në tërësi e themeltë**, kërkesëpadia e paditëses A. Z.-G. nga M, rruga xxxx. **DETYROHET** e paditura Komuna e Zubin Potokut-Drejtoria Komunale e Arsimit që paditëses në emër të kompensimit të 27% mbi pagën bazë si mësimdhënëse e licencuar me diplomë fakulteti pranë SHMU “Osman Rama” në fshatin “Cabër”, Komuna e Zubin Potokut, për periudhën kohore nga data 04.11.2019 deri me datën 30.06.2021, t’ia paguaj shumën prej 113,76 euro në muaj ku për 20 muaj arrin shumën e përgjithshme prej 2.273,40 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e ushtrimit të padisë (19.07.2021) deri në pagesën definitive, të

gjitha në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

**DETYROHET** e paditura Komuna e Zubin Potokut- Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses A. Z.B. nga Mitrovica rruga xxxxx t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej 404,00 euro ,në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur pala e paditur, për shkak të, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta prish aktgjykimin e atakuar duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditësve si të pa bazuar apo që ta kthejë çështjen në rigjykim dhe rivendosje.

Paditësja ka ushtruar përgjegjje në ankesë, duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet ankimore të të paditurës me propozimin që Gjykata e Apelit ta refuzojë ankesën si të pa bazuar, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta vërtetojë.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të të njëjtave, e në kuptim të nenit 194, 195 par.1, pika d), në lidhje me nenin 200 të LPK-së, gjeti se:

#### **Ankesa e të paditurës është e pa themeltë**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja A. Z.B. , përmes përfaqësueses së saj të autorizuar Sh. M. J., avokate nga Mitrovica, me datë 19.07.2021 ka ushtar padi ndaj të paditurës Komuna e Zubin Potokut-Drejtoria Komunale e Arsimit për kompensimin në emër të licencimit.

E paditura, në përgjegjje në padi dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si për nga baza po ashtu edhe për nga lartësia sepse konsideron se kërkesëpadija e paditëses është e paqartë ngase kompensimit në emër të 27 % mbi pagën bazë sepse neni 7 paragrafi 1 pika 3 e kontratës përmendet vetëm 27 % dhe asnjë rritje tjetër e pagës apo shtesë në pagë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, ka mbajtur seancë kryesore dhe pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.33/2021 të datës 28.10.2021 , me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses si të themeltë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimit, gjykata ka theksuar se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, ndërsa nga provat e administruara është konstatuar se paditësja është mësimdhënëse e licencuar nga data 04.11.2019, ndërsa sipas listës së pagave në emër të paditëses vërtetohet se paditësja arkëton pagën mujore në vlerë prej 421 euro dhe 27 % nga vlera e pagës mujore arrin shumën prej 113,67 euro në muaj ashtu që paditësja për periudhën kontestuese nga data 14.11.2019 deri me datën 30.06.2021 ka 28 muaj e që arrin vlerën e përgjithshme prej 2.273.40 euro, e gjithë kjo bazuar në nenin 7

paragrafi 1, pika 1.3, të Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017. Në raport me kamatën ligjore gjykata vendosi sipas nenit 382 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës vendosi sipas nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Aktgjykimi i atakuar me ankesë është i rregullt në pikëpamje të strukturës dhe përmbajtjes duke përfaqësuar kështu një vendim i cili është koherent në pikëpamje logjike dhe juridike duke eliminuar çfarëdo kontradikte për ta kualifikuar si kundërtëhënës. Mënyra e zhvillimit të procedurës dhe e hartimit të vendimit nga gjykata e shkallës së parë kanë garantuar një proces të drejtë dhe të paanshëm duke u mbështetur për përfundimin e saj në themelin faktik dhe juridik të çështjes.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pa bazuara pretendimet ankimore e të paditurës për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, në raport me gradimin-licencimin, e kjo për arsyeje se me nenin me nenin 7 të Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë parashihet se *“Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: 1.1 Mësimdhënës me Shkollë Normale 10% e pagës bazë, 1.2 Mësimdhënës me Shkollë të Lartë Pedagogjike dy vjeçare 19% e pagës bazë. 1.3 Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar 27% e pagës bazë, 1.4 Mësimdhënës me diplomë vjeçar, magjistraturë/master dhe doktoratë 35% e pagës bazë, ndërsa me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/33 të datës 29.08.2008 parashihet se nga 1 Shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësve etj do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe bashkëpunëtorëve profesional, me diplomë të shkollës normale 10 % të*

*pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me një ngritje te pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktorate) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %, prandaj, kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar. Po ashtu, edhe sipas Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës numër 214/2023 të datës 05.10.2023 çështja e kompensimit mbi bazën e kualifikimit është trajtuar ashtu që sipas këtij mendimi “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, të datës 29.08.2008” si dhe “punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021 , kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, Sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”.*

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendosjes lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së paditëses që në emër të kompensimit për licencim t’ia kompensojë shumën e aprovuar si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjithashtu, edhe vendosja lidhur me kamatëvonesën, është në përputhje të plotë me nenin 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili përcakton detyrimin e debitorit në pagesën e kamatëvonesës si pasojë e vonesës në përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit, e në rastin konkret e paditura meqë, është vonuar dhe nuk ka përmbushë detyrimin e saj ndaj kreditorit në afatin e përcaktuar me kontratë kolektive, atëherë e njëjta i detyrohet në përmbushjen e detyrimit së bashku me kamatëvonesën në shkallë prej 8% vjetore.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat nenit e 452 të LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifatat për shpenzime gjyqësore.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të paditurës, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.153/2022, datë 06.03.2024**

**Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,**

Numri i lëndës: 2021:159720  
Datë: 11.03.2024  
Numri i dokumentit: 05431648

## **Besnik Feka**